



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-

NJOFTIM PARAPRAK PËRQËNDRIMI

Rasti: 283/VII/ Përfitim Kontrolli

Hellenic Petroleum SA /BP Greece Limited SA/ BP Hellas SA

1. Në datën 3 Korrik 2009, Autoriteti i Konkurrencës ka marrë njoftimin e shkurtuar të përqendrimit të propozuar, sipas së cilës shoqëria Hellenic Petroleum SA (HelPe Greqi), përfton kontrollin e plotë në kuptim të nenit 10/1/b të Ligjit, në shoqërinë BP Greece Limited SA, nëpërmjet blerjes së aksioneve që ajo zotëron pas ristrukturimit tek BP Hellas SA (Greqi).

2. Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse:

- Për Hellenic Petroleum (HelPe): (i) prodhimi, përpunimi dhe tregtimi i karburanteve dhe nënprodukteve të tij në tregun e rrjedhës së sipërme dhe të poshtme, (ii) kërkimi i burimeve të naftës dhe gazit; (iii) prodhimi i kimikateve me bazë hidrokarburesh; (iv) prodhues dhe shpërndarës i energjisë elektrike.

HelPe ushtron veprimtari ekonomike në tregun shqiptar të karburanteve nëpërmjet filialeve të kontrolluara 100% prej tij: (i) në tregun e shumicës me Global Petroleum Albania dhe (ii) në tregun e pakicës nëpërmjet Elda Petroleum Albania Shpk.

- BP Greece Limited: është pjesë e grupit BP International, që ushtron veprimtari në tregun e prodhimit, përpunimit dhe tregtimit të karburanteve. BP Greece Limited është zotëruesi 100% i shoqërive bija që ushtrojnë veprimtarinë në tregun me shumicë dhe pakicë të depozitimit dhe tregtimit të karburanteve në Greqi: BP Oil Hellenic SA dhe BP Hellas SA Oil Trading.

BP Greece Limited nuk kontrollon asnjë ndërmarrje në tregun shqiptar të karburanteve.

BP Hellas SA Oil Trading, objektivi i operacionit (target), me seli në Greqi, ushtron veprimtarinë e saj të depozitimit dhe tregtimit në të dy nivelet e tregut (me shumicë dhe pakicë), për produktet e karburanteve të përpunuara në Greqi.

3. Nga shqyrtimi paraprak, rezulton se transaksioni i njoftuar është brenda fushës së zbatimit të nenit 2 të Ligjit.
4. Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar. Opinionet duhet të paraqiten jo më vonë se 15 ditë nga publikimi i këtij njoftimi.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (nr 0355 4 22234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr “Sami Frashëri”, Nr 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën perqendrime@caa.gov.al

Konceptoi:D. Kelliçi

Miratoi D.Dervishi